

STATUT

I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR "RETALB SERVICE" SH.P.K.

Unë , ortaku themelues :
I.Znj Loreta POLAJ , e bija e Avdulit , shtetase shqiptare lindur në Orikum 29.03.1989 dhe banues banues në Marie Kraja, Nd 62,H.2;Kashar, Yzberish;1050,Tiranë, me karte identiteti nr personal I95329074J,

Deklaroj se kam themeluar me datë 15 janar 2025 shoqërinë me përgjegjësi të Kufizuar "RETALB SERVICE" SH.P.K.

-NENI 1-

Shoqëria "RETALB SERVICE" SH.P.K. vepron ne bazë të legjislacionit shqiptar. Shoqëria është person juridik shqiptar dhe në bazë të Ligjit 9901 datë 14.14.2008 "Për Tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare" si dhe Ligjit 9723 date 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" i gëzon të drejtat e personit juridik nga momenti i regjistrimit në Qendrën Kombëtare Të Biznesit Tiranë si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar. Administratorët kanë të drejtë të hapin zyra, filiale ose përfaqësi në çdo moment në të gjithë territorin shqiptar si dhe jashtë tij.

- NENI 2 -

Selia legale e shoqërisë është në
Durrës, Xhafzotaj, Komuna Xhafzotaj , Rruga nacionale Durrës-Xhafzotaj, Zona Kadastrale 2574, Godine me nr. Pasurie 163/128, Kati I-re. **NENI 3 -**

Objekti i shoqërisë konsiston në aktivitetin :

Auto Servis
Import eksport autoveturash, furgonësh, kamionësh, autobuzësh dhe pjesëve të këmbimit të lidhura me to.

Të shërbej si pikë kontrolli teknik për automjetet e çdo lloji dhe tipi


Të shërbej si nënagjente për kompanite e sigurimit të mjeteve motorike.

Veprimtari në fushën ndërtimore.

Shoqëria ka të drejtë të bashkëpunojë me qëllim fitimi me persona juridik e fizik të çfarëdo lloji tipi dhe sido që të jenë krijuar ato.

Si dhe të ushtroj çdo lloj aktiviteti tjetër financiar, tregtare, industrial, ndërtimi , Import Eksporti etj që do të shihen në interes të realizimit të objektit social të saj.

Shoqëria gjithashtu ka të drejtë të japi hua, financime për të tretë, për shoqëri që lidhen me të ose që kontrollohen nga ortakët.



Mundet gjithashtu të marri ndihma ose financime nga çfarëdo enti publik ose privat, shqiptar ose i huaj, nga institute bankare ose nga shoqëri që lidhen me të ose kontrollohen nga ortakët.

-NENI 4-

Kohëzgjatja e shoqërisë caktohet deri më 20 vjet . Ky afat mund të zgjatet ose shkurtohet me vendim të asamblesë së ortakëve, me shumicë votash siç kërkohet për ndryshimin e statutit.

-NENI 5-

Ortakët janë të lirë të marrin pjesë në shoqëri si ortakë të vetëm ose me ortakëri si dhe të krijojnë shoqëri me objekt të njëjtë ose të ngjashëm me shoqërinë.

-NENI 6-

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100 (njëqind) lek i ndarë në 1 pjesë.

Ortakët marrin pjesë në kapitalin social si më poshtë:

1. Znj Loretta Polaj 1 pjesë me vlerë 100 lekë ose 100 % të kapitalit

-NENI 7-

Pjesët janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve. Asnjëri prej ortakëve nuk mund të transferojë ose të shesi pjesët, personave të tretë ose jashtë shoqërisë, përpara se t'ia ofrojë këto ortakëve të tjerë, të cilët gëzojnë të drejtën e blerjes në proporcion me kuotat që disponojnë. Ortaku shitës duhet të informojë ortakët e tjerë për vendimin e tij, me anë të letrës rekomande duke sqaruar të gjitha detajet e transaksionit të projektuar, duke shënuar emrin e blerësit, çmimin e shitjes dhe kushtet e pagesës.

Nëse e drejta e parablerjes nuk ekzekutohet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së njoftimit, ortaku shitës ka të drejtë të shesi pjesët e tij kujtdo personi, me kusht që çmimi i shitjes të mos jetë me i ulët se ai i propozuar ortakëve dhe as me vlerën reale .

Pjesët janë lirisht të transferueshme tek trashëgimtarët direkt, pa asnjë pengesë dhe pa qenë nevoja e miratimit të ortakëve të tjerë.

NENI 8

Organet drejtuese të shoqërisë janë :

- a) Asambleja e ortakëve.
- b) Administratorët

Asambleja e ortakëve do të emërojë një ose më shumë Ekspert Kontabël të Rregjistruar sipas kërkesave të nenit 81 të ligjit 9901/2008.

Administrator i shoqërisë do të jetë z. Loreta POLAJ , për një afat 5-vjeçar mbajtës i kartës së identitetit I95329074J

(*Loreta Polaj*)
Enxhela

Neni 9

ASAMBLEJA E ORTAKËVE

Mbledhjet e asamblesë së ortakëve do të zhvillohen në qendrën e shoqërisë ose në vende të tjera, në bazë të vendimit të Administratorëve ose nga vetë ortakët siç është parashikuar në këtë statut.

Asambleja mbledhet të paktën një herë në vit, brenda 6 muajve nga mbyllja e aktivitetit vjetor, për aprovimin e bilancit financiar.

Në çdo moment mund të zhvillohen mbledhje të jashtëzakonshme të Asamblesë , për të vendosur për detyra që janë në kopetencën e saj.

Asambleja mbledhet me kërkesën e administratorëve ose me kërkesën e ortakëve që kanë mbi 5 % votave në asamble.

Secili ortak duhet të marri me shkrim 15 ditë përpara datës së mbledhjes së Asamblesë njoftim për mbledhjen e saj. Njoftimi duhet të dërgohet me letër rekomande, e-mail , telegrame ose fax. Njoftimi duhet të përcaktojë vendin, datën, orën e mbledhjes si dhe rendin e ditës.

Njeri ose më shumë ortak që përfaqësojnë të paktën 5 % e kapitalit shoqëror mundet të kërkojnë të shtohen në rendin e ditës edhe çështje të tjera. Në rast se janë prezent të gjithë ortakët, janë të vlefshme edhe problemet që nuk janë parashikuar në rendin e ditës.

NENI 10

E drejta për të marrë pjesë në mbledhjet e Asamblesë është e kushtëzuar me regjistrimin në regjistrin e kuotave të shoqërisë. Secili ortak ka aq vota sa janë

Polaj

kuotat që ai përfaqëson. Asnjë ortak nuk ka të drejtë të votojë me një pjesë të kuotave për një vendim të kundërt me të parin.

Ortakët kanë të drejtë të përfaqësohen nga ortakë të tjerë ose të tretë.

NENI 11

Quhen të aprovuar ato vendime që janë marrë nga ortakët që zotërojnë më shumë se 50% të kapitalit të shoqërisë.

Në rastet kur nuk arrihet më shumë se gjysma e votave, ortakët detyrohen për të votuar për herë të dytë dhe në këtë rast, vendimi quhet i aprovuar në rast se voton shumica e ortakëve, pamvarësisht nga pjesëmarrja në kapitalin shoqëror.

NENI 12

Ndryshimet dhe modifikimet e këtij statuti bëhen me miratimin e ortakëve që përfaqësojnë jo më pak se dy të tretat e kapitalit shoqëror.

Konsiderohen të vlefshme vendimet që merren jashtë mbledhjes së Asamblesë por që janë të nënshkruara dhe të pranuar nga të gjithë ortakët.

NENI 13

Për sa parashikohet në ligjin shqiptar dhe në këtë statut, duke përjashtuar kompetencat që ka Asambleja e Ortakëve, aktiviteti dhe veprimtaria e shoqërisë si dhe të gjitha të drejtat shoqërore do të jenë në kompetencë të Administratorit ose Administratorëve të shoqërisë.

Administratori/ët do të emërohen nga Asambleja e ortakëve për një periudhë pesë vjecare dhe janë të riemerueshëm. Çdo Administrator do të qëndroje në detyrë deri në përfundim të mandatit dhe deri sa nuk është zëvendësuar nga një tjetër.

NENI 14

Në rast vdekje, dorëheqjeje, ose dënimi penal, mbetet bosh vendi i një ose më shumë administratorëve, Asambleja e ortakëve ka të drejtën e emërimit të zëvendësuesve.



NENI 15

Siç kërkohet nga ligji shqiptar dhe ky statut, përjashtuar kompetencat e Asamblesë së Ortakëve , aktiviteti dhe veprimtaria e shoqërisë si dhe të gjitha kompetencat e tjera do të kryhen nga Administratori/ët të cilët gjithashtu përfaqësojnë shoqërinë në marrëdhënie me të tretët dhe do të përpilojnë të gjitha aktet që lidhen me realizimin dhe qëllimin social të shoqërisë. Ne veçanti Administratori/ët kanë këto kompetenca :

a) përfaqëson shoqërinë në marrëdhënie me çdo person ose ent juridik shqiptar apo të huaj, në marrëdhënie me shtetin dhe çdo organizëm tjetër politik, ushtarak ose civil shqiptar apo të huaj, në marrëdhëniet me bankat, autoritetet gjyqësore të çfarëdo niveli, civil, penal ose administrativ, emëron ose revokon me prokurë avokat ose përfaqësues të tjerë.

b) Ka të drejtën e nënshkrimit të çfarëdo akti në emër të shoqërisë; nënshkruan kontrata të çfarëdo natyre në emër të shoqërisë; pranon garanci për çelje kredish, emërtim të garancive, nënshkruan tituj kreditimi në emër të shoqërisë, nënshkruan çeqe bankare ose qarkullues. Ka të drejtën të kryejë pagesa për të gjitha letrat me vlerë dhe çeqet qarkullues, të pranojë dhe të transferojë të gjitha llojet e dokumentave , të pranojë , mbylli dhe transferojë policat e sigurimit të çdo tipi, në interes të shoqërisë.

Kompetencat e sipërsënuara i kalojnë njërit ose tjetrit administrator sipas vendimit të Asamblesë së Ortakëve e cila gjithashtu cakton edhe shpërblimin për Administratori/ët

NENI 16

Viti financiar fillon me 01 Janar dhe mbyllet me 31 Dhjetor të çdo viti. Me mbylljen e viti financiar, administratorët përgatisin një raport mbi bilancin dhe ja paraqesin Asamblesë së Ortakëve.

Fitimi neto, pas krijimit të rezervave ligjore dhe rezervave të tjera të përcaktuara në statut, do të ndahet ndërmjet ortakëve në formën dhe mënyrat e përcaktuara nga Asambleja e ortakëve, në proporcion me kuotat në kapitalin social.

NENI 17

Shoqëria mund të prishet në afatin e përcaktuar në kontratë, përveç rastit kur Asambleja e Ortakëve vendos për zgjatjen e këtij afati.

Prishja e shoqërisë para afatit të përcaktuar mund të bëhet kur:

a. bëhet i pamundur realizimi i objektit të saj



- a. bëhet i pamundur funksionimi i asamblesë së ortakëve
 - b. Në rastet e përcaktuara në nenin 99 të ligjit 9901, të vitit 14.4.2008
 - c. Në raste të tjera të parashikuara nga legjislacioni shqiptar
- Shoqëria mund të prishet në çdo moment kur vendos $\frac{3}{4}$ e Asamblesë së Ortakëve.
Likujdimi kryhet në bazë të kërkesave të legjislacionit shqiptar.

NENI 18

Marrëdhëniet e punës, pagesat, taksat dhe sigurimet shoqërore, rregullohen sipas kërkesave të ligjit shqiptar.

NENI 19

Çka nuk është parashikuar në këtë dokument rregullohet sipas kërkesave të ligjit “Për Tregëtarët dhe Shoqëritë tregtare” dhe në përgjithësi nga legjislacioni shqiptar.
Për zgjidhjen e mosmarrveshjeve caktohet Gjykata e Tiranës.

NENI 20

Statuti u përpilua në katër ekzemplarë në gjuhën shqipe, ku një kopje depozitohet në zyrën e Noterisë Durrës.

Durres , më 15 janar 2025

O R T A K U

Loreta POLAJ

